



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 85 prot.

Kamëz, më 26.9.2025

V E N D I M
Nr. 73.Datë 26/9 2025
MBI

“DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 2, DATË 22/01/2024 "PËR PËRCAKTIMIN E DISA KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSSET PËR TO NË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.09.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-Vendimin Nr.67 Datë 23.09.2025 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative"; ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjit nr. 89, datë 22.12.2022, "Për Policinë Bashkiake"; Vendimit nr. 296, datë 28.03.2024 "Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz", pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Policisë Bashkiake, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të miratojë Projekt Vendimin "Për disa shtesa në vendimin nr. 2, datë 22/01/2024, Për përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Kamëz", si dhe bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithëshme të Policisë së Shtetit për "Vjeljen e detyrimeve të pashlyera nga kundërvajtjet rrugore dhe konvertimin e këtyre vlerave monetare në investim për Policinë e Shtetit", datë 19.09.2022 nr.6905 prot., **Këshilli Bashkiak Kamëz**";

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit Nr.2, datë 22/01/2024, për: "Përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Kamëz", të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:
 - a. Në Kreun II "Për Kundërvajtjet Administrative", konkretisht, Neni 8 "Për Kundërvajtjet Administrative në fushën e sigurisë", të shtohen:
 - b. Gërma "III", "Mosrespektimi i kritereve të parkimit rezidencial në Bashkinë Kamëz".
 - c. Gërma "IV", "Parkimi i automjeteve, në rrugët e brendshme të Bashkisë Kamëz, të pa pajisura me Kartën e Rezidentit lëshuar nga Bashkia Kamëz".
 - d. Gërma "n", "Mosrespektimi i zonës së përcaktuar në Kartën e Rezidentit, për parkimin në rrugët e brendshme të Bashkisë Kamëz".
2. Në Kreun III "Sanksionet administrative dhe mënyra e caktimit të tyre", konkretisht Neni 16



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

"Masa e gjobës për kundërvajtjet administrative kundër rregullave të bashkëjetesës shoqërore", pika 2, shtohen përkatesisht kundërvajtjet administrative të cituara në pikën 1 të këtij vendimi, duke përcaktuar një masë gjobe prej 1.000 deri në 3.000 lekë, për parkim të gabuar në zonat rezidenciale të përcaktuara nga Bashkia Kamëz.

3. Reflektohen këto ndryshime në VKB nr. 137, datë 22.12.2024 "Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz", i ndryshuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI

